



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 37-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 31. 01. 2017 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi anëtar
19. Lulzim Rustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
3. Fauz Xhemajli, Drejtor i administratës
4. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-se
5. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
6. Avni Olluri, Drejtor i GJK
7. Haset Sahiti, Drejtor i DSHP
8. Burim Rustemi, Shef i kabinetit
9. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
10. Kimete Jashanica, OSBE
11. Përfaqësues të OJQ "POLIS"
12. Bekim Krasniqi OJQ "YHR"
13. Përfaqësuesit e mediave
14. Bestar Ibrahim, Operator i teknologjis informative
15. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
16. Bajram Zaskoku, perkthyes shqip-serbisht
17. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim duke shtuar se KPF-ja ka dhënë rekomandim që si pikë e 7-të e rendit të ditës të shqyrtohet informata lidhur me pastrimin e rrugëve nga bora.

Pastaj vuri në votim rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimin për plotësim sipas rekomandimit të KPF-së dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, miratoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të të Kuvendit
2. Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit për transparencë në Komunë
3. Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit në Lipjan për rivendosjen e shtatores-bustit të veprimtarit të lëvizjes kombëtare Mulla Hamit Sllvisë.
5. Propozim Vendim për përcaktimin e destinimit dhe shpalljen e konkursit për ndarjen e banesave në pronësi të komunës
6. Raporti i auditorit të pavarur për vitin 2015 të Kompanisë Regjionale të mbeturinave "Pastrimi" SH.A.
7. Informatë për pastrimin e rrugëve nga bora.

Para se të kalohet në rendin e ditës Kryesuesja tha se është koha për pyetje dhe përgjigje të delegatëve, andaj pyes kush ka pyetje.

Linda Sahihi, kërkoj që inspekcioni të bënë një kontrollë më të madhe të marketeve meqë në disa markete ka artikuj që u ka skaduar afati dhe ato u shitën konsumatorëve gjithashtu edhe çmimet janë më të larta.

Ramiz Qeriqi, uroj që këtë vitë ekzekutivi të punoj më mirë meqë vitin e kaluar ka pasur shumë kërkesa të qytetarëve e gjithashtu edhe unë kam pasur kërkesa por përgjegjje nuk kemi marrë. Unë shumë herë kam kërkuar që të bëhet kontrollimi i shtrimit i asfaltimit të rrugëve të cilat janë shtruar keq e posaqërisht kam pasur vërejtje për asfaltimin e rrugës pas ABE-es e dëshiroj të dijë se a është kontrolluar kjo rrugë meqë pas shtrimit me asfalt në këtë rrugë ka dalur balta.

Pastaj disa herë kam pyet për pranimin e rojës në shkollën e mesme se si janë pranuar ato roje të sigurimit dhe kush i ka pranuar por nuk kam marrë përgjegjje. Për shkollën në Grackë të Vjetër disa herë kam pasur kërkesë që në këtë shkollë të zhvillohet mësimi edhe në gjuhën shqipe dhe pyes se kjo shkollë a është në Republikën e Kosovës.

Pastaj tha se për rebelimin e nxënësve në shkollën e mesme në fund të vitit a janë marrë masa se Kryetari pat thënë se nuk janë të Lipjanit në bazë të videos që e kanë paraqitë. Në vazhdim tha se kam parashtuar edhe pyetje tjera siqë është nxemja në shkollë të Krojmirit meqë gypat janë plasë, në Dobrajë nuk punojnë radiatorët, disa rrugë në Dobrajë kanë mbetë pa u shtru etj.

Vlora Limani-Hajnuni, kërkoj nga Ramizi që t'i përmbahët Rregullores së punës së Kuvendit dhe t'i parashtroj 3 pyetje e jo 15 pyetje.

Lulzim Rrustemi, uroj që këtë vit të shkon puna e mbarë edhe për ekzekutivin edhe për Kuvendin. Unë kam një kërkesë dhe dy pyetje e që kërkesa ka të bëjë që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për rexhistrimin e pronave komunale meqë këtë punë e ka kryar një komision në bashkëpunim me DEMOS-in.

Pastaj tha se Kuvendi pat filluar për marrjen e pronave të QMI-ja për shfrytëzuesit të cilët nuk i kanë kryar obligimet apo nuk i kanë realizuar projektet e tyre andaj pyes se deri ku ka shkuar kjo procedur dhe a janë të lira ato prona të cilat janë marrë për t'i vazhduar procedurat më tutje.

Pyetje tjetër kam se te tregu është një pronë e cila është folë shumë herë publikisht edhe këtu në Kuvend është premtu për dhënien në shfrytëzim të asaj prone për kategoritë e dalura nga lufta dhe pyes se deri ku kanë shkuar procedurat për këtë qështje.

Hajrije Salihu, uroj punë të mbarë Kuvendit në këtë vit. Pastaj tha se është mirë që në komunën tonë kemi profesionist të mirë e në kuadër të kësaj kemi edhe artist e ndër ta është edhe Valentina Marevci e cila së shpejti në Lipjan do të hap një ekspozitë dhe unë dashta të dijë se a ka parashtuar kërkesë për ndihmë të Kryetari dhe a do t'i ndihmon Kryetari për hapjen e kësaj ekspozite. Sa i përket videos që është paraqitë disa probleme në shkollën e mesme në Lipjan unë këtë nuk e kam ditur por konsideroj se kjo ngjarje është smadhu dhe këtë rast e ka marrë në dorë policia por nuk e dijë përfundimin e saj si ka përfundu.

Blerim Gashi, uroj që të kemi një vit të mbar të punës së Kuvendit. Pastaj tha se në planin e punës së Kuvendit për vitin 2017 për janar e kemi pasur të paraparë shqyrtimin e planit të prokurimit dhe në KPF u arsyetu se plani i punës së prokurimit nuk mund të publikohen sipas një udhëzimi administrativ dhe për mua kjo është e pa pranueshme. Pastaj shtoi se në këtë mbledhje është dashtë të jetë në rend dite edhe informata për arsim sidomos pas rezultateve që kanë dalë nga "PISA".

Vlora Limani-Hajnuni, kërkoj edhe njëherë që t'i përmbaheni Rregullores së punës së Kuvendit se rendi i ditës u aprovu dhe po i përziemi pyetjet.

Enver Kozhani, në Ribarë të Madh shkolla që një vit ka pasur probleme me nxemjen qëndrore meqë kalldoja nuk funksionon si duhet dhe kam dëgju se drejtorja ka filluar procedurën për ndërrimin e saj por nuk e di se deri ku ka ardhur kjo qështje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, falenderoj për urimin që u dha për një vit të mbarë për ekzekutivin dhe legjislativin nga parafolësit dhe në vazhdim tha se unë do të përpiqem të përgjigjem në pyetjet që i'a vlenë me u përgjigjë. Po ndalem te pyetjet e Lulit të cilat janë me vend. E para për rexhistrimin e pronave ju njoftoj se është kryar rexhistrimi dhe është material mjaft voluminoz por do të njoftoheni me këtë material. Për pronat te QMI-ja që i kemi marrë janë në procedurë gjygsore kurse për tjerat të cilat nuk ju kanë përmbajtur kontratave do të vazhdojmë t'i marrim. Për pronat me koncesion për kategorit e dalura nga lufta të cilat janë te tregu i kafëshëve na i kemi dërguar kërkesat disa herë në OSHP dhe na është kthye dhe deri sa ta marrim pelqimin për investime në partneritet publiko privat nga komisioni ndër qeveritar nuk mund të procedojmë këtë qështje. Për kuadrot që përmendi Hajrija është fakt që kemi mjaft profesionist në komunën tonë dhe jo vetë të lëmisë të arteve por edhe lëmime tjera dhe ne do t'i përkrahim këto kuadra në kuadër të mundësive buxhetore. Sa i përket videos së publikuar lidhur me rebelimin e nxënësve unë nuk mund të marr përsipër asgjë deri sa nuk marr konfirmimin zyrtarë të autorsisë së asaj video mirëpo duhet ta dijme se përgjegjësia duhet të bijë mbi ata që e kanë obligim ligjor në shkollë.

Sa i përket planit të prokurimit mund të them se as ky plan nuk ka asgjë sekrete përveq asaj që është parapa me buxhetin e komunës të cilin ju e keni aprovu dhe në këtë buxhet janë të përcaktuara vlerat e qdo projekti dhe kërkoj nga drejtori që edhe një herë t'ua dërgoj materialin për projektet e parapara.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 36-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime, Kryesuesja të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, asnjë kundër miratoi

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 36-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit për transparencë në Komunë

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Fauz Xhemajli, Drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit dhe plani i transparencës.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, ne e dëgjuam drejtorin i cili paraqiti planin ku ceku se ky plan nxirret për çdo vit dhe na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu planin dhe të njëjtin e përkrahim.

Florent Hoxha, fillimisht uroj anëtarët e Kuvendit që viti 2017 të jetë një vit i suksesshëm. Pastaj tha se ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë plan dhe shihet se ky plan është kopi pas i planit të kaluar dhe unë dëshiroj të dijë se plani i vitit të kaluar a është realizu ashtu siqë ka qenë i paraparë. Në vazhdim tha se te objektivat e këtij plani ne e dijmë se njoftimet për caktimin e mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve plasohen në Web-faqen e Komunës, kurse mbledhjet publike përveq Web faqës së komunës në formë fizike njoftimet dërgohen te tabelat e shpalljeve apo vendet publike edhe në qendrat më të mëdha siqë janë Magurja, Janjeva, etj. mirëpo mendimi im është se edhe për mbledhjet e rregullta të Kuvendit dhe të Komiteteve të informohen qytetarët përmes ftesave të publikuara edhe në qendrat që u cekën më lartë. Te objektivat numër 5 janë paraqit aktivitetet e Kryetarit për takime me qytetarë dhe është thënë një ditë në javë unë mendoj se në plan duhet me u caktu se cila ditë. Gjithashtu në plan është thënë se bëhet transmetimi përmes internetit i mbledhjes së Kuvendit dhe Komiteteve por gjerë më tani unë nuk e dijë se mbledhjet e komiteteve transmetohen.

Blerim Gashi, edhe na në parim e përkrahim këtë plan meqë rritë ritransparencën dhe është në interes tonin. Te pika 2 e këtij plani shkruan informatë për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit dhe Komiteteve dhe këtu duhet të hiqet fjale e Komiteteve se mbledhje të jashtëzakonshme nuk mbajnë komitetet.

Edita Gashi, edhe unë i bashkangjitem urimit për një vit të mbarë dhe ne si Vetvendosje e përkrahim propozimvendimin për planin për transparencë në Komunë me kërkesë që komuna t'i përmbahet këtij plani.

Lulzim Rrustemi, edhe na i përkrahim vërejtjet e PDK që i dha lidhur me këtë plan dhe plani që aprovohet duhet të zbatohet me përpikëri meqë plani i vitit të kaluar nuk është zbatuar dhe në 6 mujorin e fundit të vitit të kaluar nuk janë publikuar vendimet e formimit të komisioneve të ndryshme, vendimet për ndarje të subvencioneve e cilët persona kanë përfitu, Rregulloret e ndryshme etj. e që këto vendime, Rregullore duhet të publikohen në Web faqe. Me publikimin e planit për trnsparencë duhet të publikohet edhe plani i prokurimit edhe raporti i auditorit të brendshëm. Te neni 5 është parapa takimet e kryetarit me qytetar, OJQ, gazetarë dhe këtu propozoj që të shtohet fjala intervistat e tij.

Fauz Xhemajli, po provoj të përgjigjem në disa pyetje posaqërisht te Florenti që tha se ky plan është kopi pas të vitit të kaluar dhe unë ju them se planin e transparencës kemi obligim ligjor që të nxjerrim për çdo vit dhe ky plan ka ndryshime nga plani i vitit të kaluar. U tha se ka gabime gjuhësore por unë nuk jam gjuhëtarë dhe këto gabime do t'i përmirësojmë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja pyeti anëtarët se kush është që propozimi i Vendimit për miratimin e planit të veprimit për transparencë në komunë të aprovohet me propozimet për ndryshim dhe plotësim si vijon: që në pikën 2 te aktiviteti i planit të veprimit te njoftimi për mbledhjet e rregullta në vend të fjalës të rregullta të thuhet mbledhjet e jashtëzakonshme dhe në pikën 5 te takimet dhe intervistat e Kryetarit të komunës me qytetarë, OJQ dhe gazetarë të hiqet dhe intervistat dhe pas fjalës gazetarë të shtohet fjala një herë në javë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË
NË KOMUNË

Neni 1

MIRATOHET , Plani i Veprimit për transparencë në Komunë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i Veprimit për transparencë në Komunë

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi

III

Propozim Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Heset Sahitit, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit dhe planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese para se të hap diskutimin lidhur me këtë pikë tha se në KPF e kemi shqyrtu këtë dhe Komiteti ka dhënë vërejtje në lidhje me numrin e banorëve të komunës së Lipjanit, prandaj është mirë që të harmonizohet numri i banorëve të qytetit të Lipjanit dhe qytetit me rrethinë.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin

Xhevat Olluri, unë mendoj se diferenca është te formullimi - Lipjani me rrethin dhe veq qyteti i Lipjanit.

Labinot Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë plan dhe falënderojmë drejtorin dhe komisionin që kanë bërë një punë të mirë dhe ne e përkrahim këtë plan.

Edita Gashi, në Komitetin për Shërbime Publike e kemi shqyrtu këtë plan dhe ka pasur vërejtje për shkak të gabimeve gjuhësore dhe ky plan është dashtë të përmirësohet për gabimet gjuhësore para se të na dërgohet neve. Na si vetëvendosje e përkrahim këtë plan dhe kërkojmë që pas aprovimit në Kuvend menjëherë të filloj implementimi i tij.

Florent Hoxha, edhe na si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtuar këtë plan dhe i përgëzojmë të gjithë ata që kanë punuar në këtë plan. Ndoshta do të ishte më mirë që ky plan të quhej strategji se pse vërtetë është i kompletuar. E dijmë që është problem zbatimi i tij në praktikë, meqë gjendja në teren është alarmante. Drejtori na i dha të dhënat për aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave por konsideroj se gjendja është më e keqe se pse na kemi fshatra të cilat fare nuk janë përfshi në sistem dhe shtrohet pyetja se ato fshatra që nuk janë në sistem ku i hedhin mbeturinat. U tha se ekzistojnë disa deponi të egëra të mbeturinave dhe ato deponi duhet të eliminohen. Sa i përket stacioneve të grumbullimit të mbeturinave unë jam kundër që ato të jenë brenda zonave urbane p.sh.

stacioni afër kompanisë “Pastrimi” prapa shkollës profesionale. Ekzistojnë fonde të donatorëve të ndryshëm sa i përket menaxhimit të mbeturinave por ata donatorë kërkojnë rregulla strikte. Shpresoj që plani të implementohet në përqindje 70% dhe vota e jonë si PDK është për.

Nazmi Krasniqi, unë edhe në KPF i kam dhënë vërejtjet e mija e posaqërisht sa i përket numrit të banorëve të Lipjanit ku ndryshimi është për 3500 banorë.

Blerim Gashi, edhe ne si AKR e përkrahim këtë plan dhe e përgëzojmë drejtorin dhe komisionin për punën që ka bërë. Edhe pse ky plan është mjaft ambicioz është mirë që ne i kemi qitë vetës caqe më të mëdha. Gjendja e menaxhimit është bukur alarmante sepse përqindja e ekonomive familjare të cilat janë në sistem është e vogël. Nuk vërejta ide ose plan konkret se si me e rritë përqindjen e pjesëmarrjes së familjeve në menaxhim dhe pagesë të shërbimit të meturinave. Unë vazhdimisht kam insistuar në krijimin e një kompanie lokale për mbeturina.

Heset Sahiti, drejtor i shërbimeve publike, unë ju falenderoj për sygjerimet e juaja dhe besoj që me angazhim të të gjithëve do të arrijmë implementimin e këtij plani. Ekziston një vetëdijësim i qytetarëve për menaxhim dhe pagesë për mbeturina e gjithashtu kemi kërkesa prej këshillave të fshatrave që të futet në sistem të menaxhimit të meturinave të gjitha fshatrat. Sa i përket numrit të banorëve të Lipjanit unë po ju lus për mirëkuptim se këtu po flasim për një gjendje dinamike të shtimit të banorëve.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja Vlorë Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e vendimit së bashku me planin me kërkesën për lektorim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha vota për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Planin për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Planin për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12,20 Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13,20.

Pastaj pas pauzës në ora 13,30 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt.

IV

Propozim Vendim per caktimin e lokacionit në Lipjan për rivendosjen e shtatores bustit të veprimtarit të lëvizjes kombëtare “Mulla Hamit Sllovisë”.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën, Avni Olluri, drejtor i DGJK, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Naim Jahiri, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe të njejtin e përkrahim.

Enver Kozhani, edhe na si PDK e përkrahim këtë propozim Vendim.

Blerim Gashi, nuk e dëgjova drejtorin se a janë konsultuar edhe familjarët e Mulla Hamit Sllovisë ne e përkrahim këtë propozim Vendim.

Avni Olluri, po ne jemi konsultuar me djalnin e tij dhe jemi dakorduar për vendin e vendosjes të kësaj shtatore.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat prezent, miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT NË LIPJAN PËR RIVENDOSJEN E SHTATORES-BUSTIT TË VEPRIMTARIT TË LËVIZJES KOMBËTARE MULLA HAMIT SLLOVISË

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni me sipërfaqe prej 10m² në parcelën kadastrale P-71409044-01307-13 në vendin e quajtur “Qeramidica” zona kadastrale Lipjan P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan e evidentuar në Certifikatën Nr.5/2017, për rivendosjen e shtatores-bustit të veprimtarit të lëvizjes kombëtare Mulla Hamit Sllovisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Aktvendimi i Kryetarit të Komunës 1Nr.464-266 i datës 14.05.2010 për dhënien në shfrytëzim të pjesës së parcelës kadastrale nr.1591 ZK Lipjan me sipërfaqe prej 10m², për vendosjen e shtatores-bustit të Mulla Hamit Sllovisë.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim per përcaktimin e destinimit dhe shpalljen e konkursit për ndarjen e banesave në pronësi të komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit, drejtorit, i drejtoratit për PU, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat dhe specifikat e propozim Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, ne grupi i asambleistëve i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe të njejtin e përkrahim në tërësi.

Xhevat Olluri, edhe ne si grup parlamentar i AAK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe është mirë që më në fund komuna po krijon mundësi që t'u ndihmohet familjeve me gjendje të rëndë sociale. Ne kemi disa vërejtje në nenin 1, pika 1 është në rregull kur thuhet familjet në gjendje të rëndë sociale që nuk kanë banesë dhe propozoj që pas pikës 1 të shtohet pika 2 dhe të thuhet familjet e gategorive të dalura nga lufta, invalidët e luftës dhe veteranët e UÇK-së që i plotësojnë kriteret, ndërsa pika 2 të hiqet. Pastaj propozoj që para nenit 2 të shtohet një nen dhe të thuhet se komuna duhet të formojë një komision për caktimin e kriterëve sipas të cilave dhe në mbledhjen e ardhshme t'i miratojmë në Kuvend.

Ramiz Qeriqi, edhe unë e përkrahu diskutimin e profesorit Xhevat dhe më vjen qudi se si nuk e kanë futur në vendim si kategori pjestarët e dalura nga lufta dhe është turp për ata që e kanë hartuar këtë propozim vendim.

Florent Hoxha, edhe na si PDK pajtohemi me propozimin e profesorit Xhevat për kategoritë e dalura nga lufta dhe e përkrahim këtë propozim vendim me ndryshimet eventuale.

Blerim Gashi, shumë herë është folur për banesat në pronësi të komunës dhe është mirë që këto banesa po hyjnë në shqyrtim për ndarje. Edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim me propozimin që në vendim të parashihen kategoritë e dalura nga lufta dhe kërkojmë transparencë gjatë ndarjes së banesave.

Edita Gashi, edhe levizja Vetvendosje e përkrahim këtë propozim vendim me plotësimet që ka dhënë profesori Xhevat.

Labinot Shahini, këtu ose ka keq kuptim ose po tentohet të bëhet politikë. Askush nuk i përjashton kategoritë e dalura nga lufta dhe banesat duhet të ndahen sipas kriterëve të përcaktuara.

Ukë Kryeziu, unë e di që për këto banesa flitet e përflitet që 3-4 vite dhe tani jemi në vitin zgjedhor dhe i erdhi radha me diskutu për to. Sipas mendimit tim duhet të ndahen dy kategori: kategoria me gjendje të rëndë sociale dhe kategorit e dalura nga lufta. Pastaj pyeti se kush do ta formoj komisionin, Kryetari dhe drejtorat apo do ta bëjmë një komision gjithë përfshirës nga të gjitha partitë politike.

Lulzim Rrustemi, pyeti se a janë vetëm këto banesa në posedim të komunës apo ka edhe banesa tjera dhe a kanë ato banesa leje të ndërtimit.

Ali Stublla, nuk e di a ka logjikë që të kërkohet qira për ato banesa për të cilat u jepen familjeve në gjendje të rëndë sociale dhe familjeve të dalura nga lufta.

Nazmi Krasniqi, doktori më herët e tha se po bëhet politik por fare nuk është politikë por është realitet dhe patjetër në këtë vendim duhet të përfshihen edhe kategorit e dalura nga lufta se në sajë të tyre ne sot e gëzojmë lirinë.

Florent Hoxha, kategoritë e dalura nga lufta nuk janë raste sociale por janë kategori e veqant, prandaj si të tillë duhet të trajtohen e gjithashtu duhet të përfshihen edhe kategoritë e invalidëve civil.

Ilir Tasholli, në Ligj janë të specifikuara shumë mirë qështjet e ndarjes së banesave dhe programeve të zgjidhjes së banimit për kategoritë e veqanta dhe këtë Ligj e ka nënshkruar Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi dhe i aporovuar me 2010. Në vazhdim lexoi nën për nen specifikat e këtij Ligji dhe udhëzimet administrative që e shoqërojnë këtë Ligj. Sa i përket qiras për të cilën po flitni kjo nënkupton qiran jo profitabile nënë vlerë minimale e cila do të shfrytëzohej për mirë mbajtje të objektit ose të ngjajshme. Sa i përket lejes së ndërtimit të banesave ne kemi banesa nëpër objekte të ndryshme dhe për shkak të mos përshtatjes së kriterëve për ndërtim ato ndërtesa nuk janë legalizuar por jo për fajin tonë.

Ukë Kryeziu, drejtori tha që me Ligj Kryetari e cakton komisionin për përzgjedhje dhe pyes pse Kryetari mos me caktu komisionin nga delegatët e Kuvendit por të jenë drejtorët.

Arben Bahtiri, kjo është qështje shumë e ndjeshme dhe do të ishte mirë që të përgatitemi mirë para këtij veprimi. Ka raste sociale aq shumë edhe nga kategoritë e dalura nga lufta sa që do të duhej vërtetë të përfitojnë ata që e meritojnë.

Ramiz Qeriqi, në Rregullore po shkruan familjet me gjendje të rëndë sociale e pse këtu të mos shkruhet edhe për kategoritë e dalura nga lufta.

Sefer Tasholli, Nënkrjetar i komunës tha se këto kriterë janë të përcaktuara me Ligj që nga viti 2010, por ne para se me ardhë në mbledhje nuk e kemi konsultua atë Ligj. Është shumë keq ku pas 18 viteve pas luftës ne të mundohemi të përfitojmë nga fjala dhe sakrifica e kategorive të dalura nga lufta. Ky Kuvend më heret ka ndarë banesa dhe aty ka pasur shumë keqpërdorime por ne ia kemi vënë kapakun asaj pune. Këtë herë ne kemi vendosur që të ndajmë 21 banesa për rastet sociale por edhe për kategoritë e dalura nga lufta. Ne i kemi 850 veteran të luftës dhe po ju pyes juve a kemi mundësi ne të ndajm për të gjithë ata dhe a po ju dalim hakut veprës dhe sakrificës së tyre.

Ilir Tasholli, u tha pse komisioni me u formu nga drejtorët e jo nga të tjerët unë po ju them se ky komision ka me u formu nga drejtorët, shoqëria civile dhe nënpunës tjerë. Kunkursi do të jetë i hapur për 60 ditë dhe pas kësaj brenda 30 ditëve komisioni bënë shqyrtimin e lëndëve e mandej del e bënë verifikimin e gjendjes në teren dhe për pakënaqësitë ka mundësi ankese në Ministrinë e Planifikimit hapsinor por edhe në gjykatë.

Florent Hoxha, askush nga ne nuk jemi ata që e masim kontributin e tjetrit por ne njihemi me njëri tjetrin dhe e dijmë se qka ka punuar secili. Për ndarjet e banesave nëse bëjmë shkelje neve na kthehen vendimet nga Ministria e Pushtetit Lokal me vërejtjet përkatëse. Nuk ka më mirë për ne se sa me pas fatit me ia zgjidh qështjen e banimit një familjeje nga kategoritë e dalura nga lufta.

Xhevat Olluri, të gjithë po pajtohem që jemi para një propozim vendimi të mirë por edhe më mirë do të ishte që të futej edhe propozimi për kategoritë e dalura nga lufta. Qështje e komisionit është e drejtë e Kryetarit të komunës por kriteret do të ishte mirë që t'i debatojmë në Kuvend.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit, tha se nuk është mirë që të luajmë me fjalë. Është zhgënjyese sepse ky projekt nuk do ta zgjidh qështjen as të familjeve të skamnorëve as të kategorive të dalura nga lufta. Unë vazhdimisht kam kërkuar nga ju për propozimet e juaja paraprakisht t'i konsultoni ligjet.

Xhevat Olluri, kërkoj falje që nuk e kam bërë me shkrim propozimin tim.

Ilir Tasholli, unë mendoj se i shpjegova mirë kriteret e propozim vendimit por dikush ja nuk po don me e kuptu ja po don me bërë politikë, andaj unë po e lexoj edhe një herë

propozimin e vendimit. Unë besoj që kategorit e dalura nga lufta meritojnë tretman më serioz se sa ky që ofron ky projekt sepse këtu flitet për, banesa me kontrata të përkohëshme.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 10 vota për 19 kundër 1 apstenim çka do të thotë se vendimi u refuzua.

VI

Raporti i auditorit të pavarur për vitin 2015 të Kompanisë Regjionale të mbeturinave “Pastrimi” SH.A.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlorë Limani-Hajnuni, i dha fjalën, Gazmend Rexhepi shëf i financave në kompaninë regjionale të mbeturinave SH.A. i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga pasqyrat financiare për vitin 2015 të kompanisë regjionale “Pastrimi” shoqëria aksionare dhe raportin e auditorit të pavarur.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, edhe në KPF e kemi diskutuar këtë raport andaj pyes përfaqësuesin e kompanisë se si i kanë adresu rekomandimet e auditorit dhe si e kanë nda fitimin me njësinë operative në Lipjan.

Florent Hoxha, edhe në KPF ne i dham vërejtjet tona por nuk e dijmë sa janë dobi prurëse por më intereson sa janë aksionet e komunës së Lipjanit brenda kompanisë regjionale.

Blerim Gashi, nuk e dijmë sa është i arsyeshëm ky debat i ynë kur ne nuk kemi ndarë mjete asnjëherë për këtë kompani.

Gazmend Rexhepi, përfaqësues i kompanisë aksionet e komunës së Lipjanit janë 12% në kuadër të kompanisë regjionale.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën e shtatë.

VII

Informatë për pastrimin e rrugëve nga bora.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlorë Limani-Hajnuni, i dha fjalën, Hëset Sahiti drejtor i DSHP, i cili fillimisht njoftoi të pranishmit me procedurat e përzgjedhjes së operatorit për mirëmbajtje të rrugëve edhe për sezonin veror edhe atë dimëror. Sezoni dimëror fillon me 15 nëntor dhe zgjatë deri me 31 mars dhe ne me kohë i kemi bërë rekomandimet tona kompanisë për përgatitjet e nevojshme për t’u ballafaquar me sfidat nga reshjet e mundëshme të borës. Në vazhdim në mënyrë detale paraqiti vendbanimet ku ka pasur vështësi në qarkullim nga bora dhe orteqet. Lidhur me gjendjen e krijuar nga reshjet e borës komuna ka formuar shtabin emërgjent i cili pa ndërprerë ka punuar në përcjelljen e gjendjes dhe mundësive të sanimit të gjendjes dhe besoj që edhe për kundër gjendjes së rëndë është arritur që ta mbajmë në kontrollë situatën.

Pastaj Kryesuesja hap diskutimin?

Florent Hoxha, na kemi propozuar që të bëhet një informatë lidhur me gjendjen e rrugëve pas të reshurave të borës. Vitet më parë nuk ka pasur reshje të borës por këtë vit kishte shumë borë dhe ne e kemi bërë një analizë dhe kemi ardhur në konstatim se ekzekutivi ka dështuar plotësisht në këtë rast. Duke e parë gjendjen në qendrën komunale sa ka qenë keq ne mund ta imagjinojmë sa keq është nëpr fshatra. Prandaj mund të themi

se qëllimi i këtij ekzekutivi nuk është interesi i qytetarëve por keq menagjimi dhe keq përdorimi. Pyes se a e ka ditur ekzekutivi që kompania e kontraktuar nuk posedon as për së afërmi mekanizmin e nevojshëm për pastrimin e borës. Drejtori tha se problem ishin fshatrat malore por ne kemi pasur probleme edhe në fshatrat e rrafshit, për këtë arsye ka pasur vetë organizim të qytetarëve për hapjen e rrugëve. Në fund tha se pyes drejtorin apo ekzekutivin se qfarë masash janë marrë ndaj kompanisë për mos kryerjen e mirë të punëve.

Feriz Hasani, unë mendoj se problemi është te forma e kontratës dhe mendoj se forma më e mirë e kontraktimit do të ishte me orë pune. Unë po ashtu e di që kompania pas reshjeve që kanë qenë ka bërë punë të mirë.

Ramiq Qeriqi, unë do t'i ceku vetëm dy raste njëri në Leletiq ku fshatarët janë organizuar dhe kanë paguar 100 euro një kompani për pastrimin e borës dhe do të ishte mirë që kompania "Pastrimi" t'ua kompenzoj këto mjete dhe rasti tjetër është që dua ta felenderoj Elmi Bublicën për pastrimin e rrugëve në Dobrajë.

Lulzim Rustemi, situata nuk është menagjuar mirë dhe ekzekutivi nuk është dashur të pyes për qmim por është tashur të angazhoj kompani shtesë.

Naim Jahiri, unë mendoj se gjendja nuk është ashtu zih siqë e paraqet opozita dhe ne e dijmë se ka pasur edhe vite tjera kur nuk është vepruar fare në këtë drejtim.

Hajrije Salihu, është e vërtetë që situata me borën nuk është menagjuar mirë por unë po e paraqes një shqetësim për parkingun e shkollës profesionale ku ne ose po duhet me i parku veturat te Viva freshi ose te gjimnazi se nuk kemi vend.

Sefer Tasholli, vërtetë ne jemi ballafaquar me një situatë mjaftë të rëndë pas reshjeve të borës dhe kjo ka zgjatur mbi 10 ditë me temperatura të ulëta dhe reshje mjaft të mëdha të borës. Ne kemi arritur që brenda 3 ditësh t'i pastrojmë të gjitha rrugët. Të kemi parasysh se kjo situatë ka ditë me krijue gjendje të jashtëzakonshme në tërë Evropën ku ka pasur edhe viktimë e tek ne për fat

nuk kemi pasur asnjë viktimë.

Enver Kozhani, nuk është e vërtetë se të gjitha rrugët kanë qenë të kalueshme dhe këtë e vërtetoj me faktin se unë vet jam kthyer prej livadheve të Kraishtës dhe kam shkuar për Poturovc.

Florent Hoxha, Nënkryetari tha që kur ka qenë në opozitë nuk ka folur keq e unë po them se ka folë edhe më keq se sa fola unë. Unë nuk po flas vetëm që po e kam të drejtën por me të vërtetë ka pasur dështime.

Nehat Tërpeza, në fshatin tim unë kam dalë me bashkë fshatarët dhe e kemi pastruar borën.

Shkelzen Hajdini, unë po ju lus mos të flisni vetëm politikisht. Ne i kemi hapur të gjitha rrugët por era që ka fryer më pas në disa vende i ka mbyllë.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,²⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni